



Takimi i Europës me fatin

Ku po shkon politika e jashtme e BE-së?

Schroeder bën thirrje për krijimin e "Shteteve të Bashkuara të Europës"

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.4, Shtator - Tetor 2011

Speciale

Rikthimi në auditore: "Dimensionin europian" dhe renditja e universiteteve shqiptare

Në prag të fillimit të vitit akademik në universitetet shqiptare, EuroSpeak eksploron një aspekt themelor të afrimit të auditoreve shqiptare me ato europiane, nivelin e pjesëmarrjes së studentëve dhe akademikëve në programet që ofron Bashkimi Europian.

Gjithashtu në brendësi, informacion mbi renditjen e universiteteve në Shqipëri.

Intervistë me Znj. Helen Skikos, Oficere për Shqipërinë dhe vendet e rajonit në Drejtorinë e Përgjithshme për Edukim dhe Kulturë të Komisionit Europian.

...vijon në faqen 2 >>

Europa rrezikon të mbetet mbrapa në garën për investime në energjinë e gjelbër. Kryesojnë vendet në zhvillim



Foto: www.renewable-energy-news.info

Një raport i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin tregon se Europa rrezikon të mbetet prapa në garën e investimeve në teknologjinë e gjelbër.

Vitin e kaluar, investimet në

teknologjinë e gjelbër në nivel botëror u rritën me një të tretën, një rekord prej 211 miliardë dollarësh. Një kontribut i madh vjen nga investimet në Kinë, sidomos në centralet e erës. Pothuajse 50 miliardë dollarë janë investuar nga Kina, një rritje prej më shumë se një e katërta krahasuar me vitin 2009, duke i konfirmuar asaj vendin e parë në botë për investimin në energjinë e gjelbër.

...vijon në faqen 3 >>

Një impuls i ri për procesin e zgjerimit?



Foto: www.disputeabout.eu

Në vijim të propozimit të Ministrisë të Jashtëm Grek në takimin e Ministrave të BE-së në muajin qershor për të organizuar në Shqipëri një vizitë me synim ndihmën në kapërcimin e ngërçit politik në Shqipëri, Ministrat e Jashtëm të Italisë dhe Greqisë Frattini dhe Lambrinidis zhvilluan më 12 Shtator 2011 një vizitë në Tiranë. Përfaqësuesit e dy vendeve fqinjë, gjatë qëndrimit në Tiranë, përçuan një mesazh inkurajues, miqësor për klasën politike, që të ecë së bashku, drejt një Pakti Kombëtar për Integrimin Europian, duke mundësuar plotësimin e 12 prioriteteve të identifikuara në Opinionin e Komisionit Europian.

Pak kohë më parë, Ministri i Jashtëm Italian Frattini dhe

...vijon në faqen 8 >>



Rikthimi në auditore: “Dimensioni european”

...vijon nga faqja 1 >>



Karikatura: Rael Hoxha

EuroSpeak: Znj. Skikos, ju bashkëpunoni me Shqipërinë dhe vendet e rajonit në rrugëtimin e tyre drejt BE-së në mënyrë të veçantë për sa i përket edukimit dhe kulturës. **A mund të na jepni një përshtypje të përgjithshme mbi evoluimin dhe gjendjen e arsimit të lartë në Shqipëri, duke iu referuar këtu dhe një krahasimi me vendet e rajonit?**

Znj. Skikos: Edhe brenda BE-së jo të gjitha shtetet anëtare janë në të njëjtin nivel dhe jo të gjitha kanë pasur të njëjtën pikë fillestare. Prandaj, nga ky këndvështrim unë mendoj se është më mirë që gjendja e arsimit të lartë në Shqipëri të krahasohet me të kaluarën. Krahasimet midis vendeve nuk janë gjithmonë të dobishme. Ajo që është e dobishme është të analizojmë progresin.

Në këtë këndvështrim, më duhet të them se reformat janë ndërmarrë. Sistemi i tre cikleve sipas Bolonjës, si dhe implementimi i ECTS (Sistemi European i Transferimit të Krediteve) tashmë aplikohen. Cikli i tretë (doktoratura) ka nevojë për më shumë punë, por ai është cikli më i vështirë dhe që kërkon kohë dhe investime. Masat për vërtetimin e cilësisë dhe sistemet e akreditimit ekzistojnë. Një Kornizë Kombëtare e Kualifikimeve është në zhvillim. Ndoshta gjërat nuk janë aq të shpejta sa çdo të dëshironim, por korniza legislative (ligjet dhe aktet nënligjore) të nevojshme janë ndryshuar dhe vazhdojnë të ndryshohen. Zbatimi i reformave të lartpërmendura duhet të rishikohet dhe të përmirësohet. Askush nuk e bën çdo gjë në rregull që me herën e



dhe renditja e universiteteve shqiptare

...vijon nga faqja 2 >>

parë. Procesi i Bolonjës, siç nënkuptohet dhe nga vetë emri, është një proces i vazhdueshëm. Gjëja e rëndësishme është që të vazhdohet në këtë rrugë të gjatë dhe shpesh të vështirë. Unë jam e bindur se Shqipëria do ta bëjë këtë.

EuroSpeak: Si do ta vlerësonit progresin e deritanishëm të Shqipërisë për sa i takon ratifikimit të marrëveshjeve dhe përfshirjes në programet BE-së?

Znj. Skikos: Jam shumë e lumtur të njoftoj se pas një periudhe të gjatë stanjacioni në procedurat që çojnë drejt pjesëmarrjes së plotë të Shqipërisë në Programin e Kulturës, Zëvendësministrja Turku ishte shumë e shpejtë në dërgimin e informacionit të nevojshëm. Në këtë periudhë, ne po përgatisim një Memorandum Mirëkuptimi mes BE-së dhe Shqipërisë. Shpresojmë që Shqipëria do të jetë po aq e shpejtë në nënshkrimin e tij dhe kështu të lejojë pjesëmarrjen e operatorëve kulturorë në programin e Kulturës në periudhën e ardhshme të aplikimit të këtij viti dhe në vitet në vijim. Në fakt, afatet e ardhshme janë këtë vjeshtë. Ne mund të vlerësojmë paraprakisht projektet që përfshijnë dhe Shqipërinë, por në qoftë se Memorandumi i Mirëkuptimit nuk nënshkruhet deri në momentin kur të bëhet zgjedhja përfundimtare, atëherë këto projekte nuk do të jetë në gjendje të marrin fonde. Prandaj ka një urgjencë për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit para fundit të këtij viti.

Kohët e fundit, ne kemi hapur mundësi të reja bashkëpunimi mes Shqipërisë (dhe vendeve të tjera në Ballkanin Perëndimor) dhe BE-së në

Nëse Memorandumi i Mirëkuptimit për Programin e Kulturës nuk nënshkruhet deri në fund të vitit, projektet që përfshijnë Shqipërinë nuk do të mund të marrin fonde.

fushën e arsimit dhe trajnimeve. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ishte e para nga rajoni që iu përgjigj kërkesës në lidhje me interesin

tonë për pjesëmarrje në aktivitete të caktuara të Programit të të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (Lifelong Learning Programme). Një Memorandum Mirëkuptimi është gjithashtu duke u zhvilluar për këtë dhe shpresojmë se edhe ai do të nënshkruhet para fundit të vitit. Ne kemi parë një interes shumë të fortë nga Ministria për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një tjetër iniciativë të re, " Platforma për Edukim dhe Trajnim për Ballkanin Perëndimor ", që do të nisë në vitin 2012. Kjo platformë do të sjellë së bashku përfaqësues nga ministritë përgjegjëse për arsimin në Ballkanin Perëndimor për të diskutuar çështje me interes për to dhe do të jetë i informuar për zhvillimet e fundit politike në shtetet tona anëtare. Ministria ka siguruar tashmë një person kontakti për Platformën dhe Ministri Tafaj duket shumë mbështetës ndaj të dyja këtyre iniciativave të reja.

EuroSpeak: Tashmë studentët dhe akademikët shqiptarë kanë mundësi konkrete të vizitojnë universitete dhe institucione prestigjioze europiane nëpërmjet programesh bursash apo shkëmbimi si Erasmus Mundus, Tempus, FP7 etj. A mund të na ilustroni me shifra nivelin e pjesëmarrjes/përfitimit deri tani? A është i kënaqshëm ky nivel në një pamje më të gjerë (krahasuar me vendet e rajonit)? Nëse jo, cilat gjykoni se janë barrierat kryesore?

Znj. Skikos: Niveli i pjesëmarrjes nga institucionet shqiptare dhe individët në programet që ju përmendet, si dhe dy të tjerë, Jean Monnet dhe Marie Curie mund të përmirësohet në



Karikatura: Rael Hoxha

mënyrë të ndjeshme. Në mënyrë që të ndihmojmë Shqipërinë që të performojë më mirë ne, së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, do të organizojmë një **seminar** të posaçëm në Tiranë, më **8-9 nëntor**. Ky seminar do t'i dedikohet politikës së BE-së në arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor, por edhe çka është më e rëndësishmja, paraqitjes së të gjitha programeve të BE-së në këto fusha në të cilat Shqipëria mund të marrin pjesë. Përveç kësaj, do të ketë ndihmë teknike të siguruar nga ekspertët e BE-së për të aplikuar për këto programe. **Seminari do të mbledhë rreth 250 persona nga i gjithë vendi me një fokus të veçantë tek ata jashtë Tiranës, pasi nuk duken të informuar.**

EuroSpeak: Kohët e fundit në Shqipëri debati mbi arsimin e lartë është fokusuar në një

renditje të universiteteve të kryer nga MASH, e cila ka për synim krahasimin cilësor mes institucioneve. Cili është vlerësimi juaj për këtë nisëm? A gjykoni se do të ndikojë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri?

Znj. Skikos: Renditja është një çështje e ndërlikuar. Asnjë institucioni nuk i pëlqejnë tabelat e renditjeve, përveç se kur ndodhet në krye të tyre. Kriteret mbi të cilat është bazuar renditja janë më të rëndësishmet dhe ato duhet të komunikohen hapur dhe të diskutohen në një proces transparent. Bazuar në informatat që unë kam, kjo është një përpjekje nga Ministria për të dhënë mbështetje me fonde bazuar në meritë, diçka e praktikuar në shumë vende. Duhet të theksoj gjithashtu se kur është fjala për arsimin, nuk ka një strukturë apo procedurë që

t'u përshtatet të gjithëve. Historia e vendit dhe traditat duhet të merren parasysh. Megjithatë, ka shembuj të BE-së që mund të konsultohen. Përmes instrumentit TAIEX të BE-së, Ministria mund të vizitojë administratat e tjera në BE, si dhe të marrë ekspertizë relevante në Shqipëri. Do të duhet të presin dhe të shohin rezultatet e procesit, si dhe ndikimin. Megjithatë, një gjë që është zakonisht e sigurt me renditjen është se arsimit të lartë në këtë rast i jepet një vëmendje e madhe, dhe kjo është diçka e mirë. Diskutimet,

Skikos: Asnjë institucioni nuk i pëlqejnë tabelat e renditjeve, përveç se kur ndodhet në krye të tyre. Kriteret mbi të cilat është bazuar renditja janë më të rëndësishmet dhe ato duhet të komunikohen hapur dhe të diskutohen në një proces transparent.

debatet dhe madje edhe kundërshtimet, janë të gjitha pjesë e procesit. Gjithashtu ajo që ndodh zakonisht është që kur gjërat sqarohen, institucionet angazhohen në këtë "konkurrencë" dhe ndryshojnë sjelljen e tyre në mënyrë që të jenë më të mira dhe të shihen si të tilla. Si do të ndikojë ky proces që të krijojë qartësi në Shqipëri? Koha do ta tregojë.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

Renditja e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

Në datën 15.07.2011 Qendra për Zhvillimin e Arsimit të Lartë me qendër në Gjermani (Centrum fuer Hochschulentwicklung- CHE), kontraktuar nga MASH shpalli rezultatet e renditjes pilot të institucioneve të arsimit të lartë, për programet e studimit të ciklit të parë (Bacelor) në fushat e ekonomisë, shkencave sociale, drejtësisë dhe infermierisë. Qasja metodologjike e përzgjedhur për renditjen në Shqipëri, është shumë-dimensionale.

Klasifikimi i institucioneve është realizuar më gjerësisht në tre grupe:

- grupi i sipërm (ngjyra jeshile), ■
- grupi i mesëm (ngjyra e verdhë), ■
- grupi i poshtëm (ngjyra e kuqe). ■

Qëllimi kryesor i renditjes, është informimi më i mirë i studentëve për ofertën në sistemin tonë të arsimit të lartë. Këtij qëllimi, i shërben edhe renditja shumë-dimensionale. Ajo ofron një gamë të gjerë treguesish që e ndihmojnë studentin të zgjedhë shkollën e lartë.

Drejtësi	Institucionet	Kualifikimi i personelit						Infrastruktura më e mirë				
		Kualifikimi i personelit	Raporti pedagog / studentë	Treguesi i punësueshmërisë	Orientimi ndërkombëtar	Çështje të vecanta të mësimdhënies	Treguesi i cilësisë	Publikimet më të mira	Veprimtaria shkencore	Reputacioni në kërkim shkencor	Reputacioni në Arsim	Infrastruktura më e mirë
SHLUP	"Universiteti Amerikan i Tiranës"	■	▲	■	■	■	■					
SHLUP	"Universiteti European i Tiranës"	▲	■	■	■	■	▲	▲	▲	▲	▲	
SHLUP	"Illyria"	■	▲	■	▼	▼	▼					
Universiteti	"Ismail Qemali", Vlorë	▼	▼	▼	■	■	▼					
SHLUP	"Justicia"	▲	■	■	■	■	▲					
SHLUP	"Justiniani I"	▼	■	■	■	■	■	▲				
SHLUP	"Universiteti Kristal"	▼	▼	■	■	■	■					
SHLUP	"Luarasi"	■	■	■	■	▼	■		▲	▲		
Universiteti	"Luigj Gurakuqi", Shkodër	▼	■	■	■	▼	▲		▲			
SHLUP	"Universiteti Marin Barleti"	■	■	■	■	■	■			▲		▲
SHLUP	"Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës"	▼	■	▲	■	■	■					
SHLUP	"University of New York - Tirana"	▼	■	■	■	■	■			▲	▲	▲
SHLUP	"Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi"	▼	▲	■	▼	■	■					
SHLUP	"Wisdom University"	▲	■	■	■	■	■	▲				

* = Rating Indicator

Kualifikimi i pedagogëve është sigurisht treguesi më i rëndësishëm i cilësisë në një institucion të arsimit të lartë. Kjo do të thotë që studenti që dëshiron të studiojë në një nga fushat e mësipërme duhet të shohë se cila shkollë e lartë ka personelin akademik me nivelin më të lartë të kualifikimit, do me thënë, shkolla që për këtë parametër është renditur në "grupin e sipërm (ngjyra jeshile)".

* Për renditjen e institucioneve të arsimit të lartë në degët e tjera, vizitoni faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

<http://www.mash.gov.al/faqe.php?id1=1&id2=86&id3=209>

Pjesëmarrja e akademikëve dhe studentëve shqiptarë në programet e Bashkimit European

Programi Erasmus Mundus

I. Programe të përbashkëta (master ose doktoraturë)

Që nga viti 2009, programet e përbashkëta Erasmus Mundus zhvillohen nga konsorciume mes institucioneve të arsimit të lartë në BE dhe vendeve të tjera të botës. Aktualisht ka 131 programe Masteri dhe 34 Doktorature të mbështetura financiarisht nga BE-ja të cilat ofrojnë bursa për studentët dhe studiuesit. **Deri më tani, asnjë konsorcium me partner nga Shqipëria nuk është përfshirë mes të përzgjedhurve.**

Studentët dhe kërkuesit shqiptarë që kanë përfituar nga programi Erasmus Mundus:

Viti	Studentë Erasmus Mundus	Programet Master	Doktoraturat për e përbashkëta	Total
2004	2	0	na	2
2005	4	0	na	4
2006	4	1	na	5
2007	26	0	na	26
2008	19	2	na	21
2009	19	0	na	19
2010	17	na	0	17
2011	18	na	1	19
TOTAL	109	3	1	113

Pjesëmarrja individuale e studentëve dhe akademikëve: **Që nga viti 2004, janë përzgjedhur 109 studentë shqiptarë, kryesisht nëpërmjet një fondi special për Ballkanin Perëndimor.**

Gjithashtu, programet e Masterave Erasmus Mundus mund të ftojnë kërkuesit të studiojnë ose bëjnë kërkime. Deri më tani, në këtë program kanë marrë pjesë 3 kërkues nga Shqipëria.

Sa u takon doktoraturave, për herë të parë, në vitin 2011-2012, u pranua një kandidat shqiptar.

II. Partneritete Erasmus Mundus (mes institucioneve të arsimit të lartë në BE dhe atyre shqiptare)

Që nga viti 2008, vetëm katër institucione të arsimit të lartë publik në Shqipëri kanë arritur të ndërtojnë partneritete me institucione homologe në kuadër të programit Erasmus Mundus. Siç edhe mund të pritët, numrin më të madh të partneriteteve e gëzon Universiteti i Tiranës: me Universitetin e Gentit (Belgjikë), të Gracit (Austri), City University Londër (Britania e Madhe), dhe Universitetin e Roterdamit (Holandë). Pas tij, vjen Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër me partneritete në Universitetin e Gentit (Belgjikë) dhe të Gracit (Austri); Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, i cili gëzon partneritet me Universitetin e Gentit (Belgjikë) dhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan i cili nga ky vit, ka partneritet Universiteti Mälardalan (Suedi).

Këto partneritete kanë mundësuar lëvizjen e kategorive të mëposhtme të qytetarëve nga Shqipëria:

VITI	Bachelor	Master	Doktoraturë	Post-doktoraturë	Staf	Total
2008	3	17	2	0	14	36
2009	9	12	2	1	6	30
2010*	19	14	7	3	33	76
2011*	46	18	7	5	8	84
TOTAL	77	61	18	9	61	226

*E planifikuar

Programi Jean Monnet

Programi Jean Monnet synon të rrisë njohuritë në lidhje me integrimin evropian, duke nxitur mësimdhënien, hulumtimet dhe debatin mbi historinë, politikën, ekonominë dhe të drejtën e Bashkimit Evropian si dhe marrëdhëniet e BE-së me zonat e tjera të botës.

Në vitin 2011, janë marrë 5 aplikime nga Shqipëria. Tre nuk plotësonin kriteret prag dhe asnjëri nuk u përzgjedh.

Vendi	Projekte të vitit 2011	Numri total Vitet 2007-2011
Shqipëria	0	0
Bosnje Hercegovina	0	0
Kroacia	3	13
Kosova	0	0
Mali i Zi	0	0
Maqedonia	1	3
Serbia	1	2

Iniciativat Marie Curie (Programi PEOPLE, buxheti total 4.7 milionë euro)

Të dhëna për vitet 2007 – 2010

Qëllimi i Programit Marie Curie është të mbështesë zhvillimin e burimeve njerëzore në kërkimin shkencor, nëpërmjet nismave të veçanta të shkëmbimit ndërkombëtar dhe ndër-sektorial. Në mënyrë të veçantë synohet trajnimi dhe mbështetja e kërkuesve në zhvillimin e karrierës. Pjesëmarrësit përzgjidhen në bazë të ekselencës akademike.

Ndërkohë që asnjë institucion shqiptar (universitete, institute kërkimi, biznese) nuk merr akoma pjesë në programin Marie Curie, tetë kërkues janë financuar nga programi (si individë).

Pjesëmarrja e kërkuesve (si individë):

Kërkues të huaj që kanë vizituar Shqipërinë	0
Mobiliteti i 8 kërkuesve shqiptarë të financuar	Mbretëria e Bashkuar – 2 Gjermani – 1 Itali – 1
1 kërkues shqiptar ka përfituar grant re-integrimi për tu kthyer në Shqipëri	Holandë – 1 Suedi – 1 Slloveni – 1



Programi Tempus: Aplikime dhe projekte të pranuar

Tempus është programi i Bashkimit Evropian që mbështet modernizimin e arsimit të lartë në zonën përreth BE-së (Evropa Lindore, Azia Qendrore, Ballkani Perëndimor dhe rajoni i Mesdheut). Në Ballkanin Perëndimor, Tempus kontribuon në përgatitjen e vendeve candidate dhe atyre candidate potenciale që të marrin pjesë në programin e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (Lifelong Learning Programme).

	2008			2009			2010			2011			Tot. Të suksesshme
	Koordinator	Partner	Të suksesshme	Koordinator	Partner	Të suksesshme	Koordinator	Partner	Të suksesshme	Koordinator	Partner	Të suksesshme	
Shqipëria	2	28	7	1	32	3	2	23	5	3	28	5	20
Bosnje Herc.	5	41	9	5	56	7	5	33	6	5	50	8	30
Kosova	2	17	6	3	20	6	3	20	5	1	22	5	22
Mali i Zi	3	20	7	5	26	4	2	17	4	3	39	8	23
Maqedonia	9	68	16	10	56	10	6	41	7	--	--		33*
Serbia	12	66	17	25	81	13	18	49	12	27	74	11	53

*Mungojnë të dhënat për vitin 2011



Një impuls i ri për procesin e zgjerimit?

...vijon nga faqja 1 >>

ai Slloven Zbogar, i drejtuan një letër të përbashkët Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë Ashton dhe Komisionerit për Zgjerimin Fule, ku kërkohej përshpejtimi i axhendës së integrimit europian. Sipas tyre, mbyllja e bisedimeve teknike BE-Kroaci vërteton edhe një herë fuqinë magnetike të BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në drejtim të promovimit të paqes, demokracisë, stabilitetit dhe prosperitetit. Në të njëjtën kohë, aderimi i Kroacisë dëshmon se dyert e BE-së janë të hapura, për sa kohë që kriteret përmbushen vendosmërisht nga vendet aspirante.

Për Frattinin dhe Zbogar, vendet më të përparuara në këtë proces janë Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, falë përmbushjes së reformave. Ndaj, BE-ja duhet të angazhohet "duke kapitalizuar edhe mbi suksesin e Kroacisë" që t'i mundësojë këtyre vendeve kalimin në fazën tjetër të procesit të integrimit europian (akordimi i statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për aderim me Serbinë; fillimi i bisedimeve për aderim me Maqedoninë dhe Malin e Zi).

Ndërkaq, për Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën dhe Kosovën, kërkesat e Frattinit dhe Zbogar ndaj BE-së, kufizohen vetëm në dhënien e një mesazhi të qartë në favor të perspektivës europiane, duke inkurajuar kështu ndërmarrjen e reformave të duhura. Por, letra e tyre nuk specifikon instrumentin që do ta bënte perspektivën europiane të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës dhe Kosovës edhe më të prekshme.

Duhet theksuar se Italia, Greqia, Sllovenia dhe Austria edhe në të shkuarën kanë propozuar iniciativa në thelb të ngjashme, por që nuk kanë arritur të rrokin mbështetjen e vendeve me peshë më specifike. Duket se edhe këto veprime të përbashkëta të fqinjëve nuk do të ndryshojnë shumë rrjedhën e ngjarjeve në rajon, aq më tepër kur progresi varet nga stadi dhe cilësia e reformave. Kancelaria Gjermane Angela Merkel dha sinjalin e parë në fund të gushtit kur paralajmëroi Serbinë se, statusi i vendit kandidat do të varet nga tërheqja e strukturave paralele serbe në Kosovë.

Ashton: Trysnia që ka më shumë peshë është e brendshme, nga njerëzit që duan të ndryshojnë vendin dhe jetët e tyre.

Vetë zyrtarët e BE-së këmbëngulin për një proces që do të bazohet mbi kushtëzimin demokratik dhe meritën, duke kërkuar aleancë me qytetarët e rajonit për sa i përket ushtrimit të trysnisë së brendshme në funksion të zhvillimit e përparimit. Teksa vizitonte Beogradin, menjëherë

pas arrestimit të Ratko Mladicit, Baronsha Ashton deklaroi në mënyrë elokumente se: "Ne nuk do të dhe nuk duhet të japim lehtësisht anëtarësime në BE. Ne kërkojmë demokraci funksionale, ekonomi të hapur, drejtësi të pavarur dhe fund korrupsionit. Trysnia jonë dhe ndihma praktike po japin fryte ndërkohë. Por trysnia që ka më shumë peshë është e brendshme, nga njerëzit që duan të ndryshojnë vendin dhe jetët e tyre".

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

Europa rrezikon të mbetet mbrapa në garën për investime në energjinë e gjelbër. Kryesojnë vendet në zhvillim

Rritje shënojnë gjithashtu dhe India dhe disa vende të Amerikës Latine. Në Europë, në të kundërt, investimet në këtë fushë kanë rënë me një të pestën (35 miliardë dollarë). Megjithatë, në shkallë rajonale, pamja është më e ndritur, ku dallohet Gjermania me investimet e saj të rëndësishme, veçanërisht sa i takon energjisë diellore.

Një nga karakteristikat më të habitshme të vitit 2010 ishte se në aspektin e investimeve financiare të reja - përfshirë financimin e asetëve, kapitaleve, kapitalit privat dhe investimeve në tregjet e aksioneve publike - për herë të parë vendet në zhvillim i lanë mbrapa ekonomitë e zhvilluar. Investimet arritën në 72 miliardë dollarë në vendet në zhvillim dhe 70 miliardë dollarë në botën e industrializuar.



Kartolina nga BE-ja

Takimi i Europës me fatin

Hugo Brady, studiues pranë Qendrës për Reformë Europiane (Centre for European Reform), një think tank britanik prestigjioz, analizon skenarët e mundshëm të mbijetesës së BE-së. Për herë të parë që nga krijimi, në pranverën e vitit 2010 sondazhet treguan se shumica e europianëve e kanë humbur besimin në projektin politik të BE-së, duke përfshirë këtu edhe francezët e gjermanët. Autori merr shkas nga situata aktuale në BE që karakterizohet nga një mjedis politik i helmatisur për shkak të staniacionit ekonomik dhe humbjes së influencës ndërkombëtare. Sipas tij, tri janë drejtimet që mund të ndjekë rrjedha europiane:



Foto: DFS.AL

1. Diskreditimi i projektit European si pasojë e shkatërrimit të euro-s si monedhë e përbashkët dhe ruajtja e disa elementëve të tregut të brendshëm duke bashkëpunuar në nivel ndërqeveritar përmes Shoqatës Europiane për Tregtinë e Lirë (EFTA – organizëm i Zvicrës, Islandës dhe Norvegjisë përmes të cilit këto shtete marrin pjesë në disa prej politikave të BE-së). Ky skenar nuk ka gjasa të ndodhë, për sa kohë vihet re vendosmëria e Gjermanisë dhe e Presidentit të Këshillit European për ta ruajtur monedhën, pasi sipas tyre, shkatërrimi i monedhës implikon edhe fundin e projektit european.
2. “Euro-skleroza” – e ngjashme me vitet 1970-1980 ku mbizotëronte inflacioni, rritja e dobët ekonomike dhe paqëndrueshmëria politike.

Sipas këtij skenari, euro shpëton pas largimit të Greqisë dhe Portugalisë nga zona euro dhe pas ndërhyrjes radikale të Fondit European për Stabilitet Financiar. Pavarësisht disa hapave të kufizuar drejt integritit fiskal, udhëheqësit european nuk do të lëshojnë më euro bonde. Kjo do të pasohet me largime të tjera nga zona euro. Ndërsa vendet që do të përbënin zemrën e saj nuk do të shkonin drejt bashkimit politik.

3. “Euro-federalizmi” – që do të kërkonte përpjekje të mundimshme nga vendet anëtare të BE-së për të gjetur forma të tjera bashkëpunimi politik e fiskal, për të parandaluar shkatërrimin e euro-s dhe shpërbërjen e BE-së. Situata aktuale politike nuk e favorizon një skenar të tillë që ngërthen në vetvete negociatën për një traktat të “Bashkimit Ekonomik European”, çka do të përkthehej në një stinë negociatash substanciale nga ana e Mbretërisë së Bashkuar, ose në largimin e saj nga BE-ja. Ndërkohë që një skenar i tillë nuk është edhe aq realist pasi nuk lejon fleksibilitet (forma të ndryshme anëtarësimi apo monedha vendase).

Një herë e një kohë, Margaret Thatcher e përshkruante BE-në si “vizioni i së djeshmes për të ardhmen”. Pavarësisht turbullirave, BE-ja gjendet më shumë se kurrë para një “momenti kushetues”. BE-ja në formën ekzistuese dhe euro-ja si monedhë u projektuan në një periudhë unike të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe zgjerimit të lirive ndërmjet viteve 1989 dhe 2008, çka do të thotë se vendet anëtare binin në ujdi më kollaj për integritimin european. Sot, kohët kanë ndryshuar, si pasojë e krizës së borxheve dhe nacionalizmit në rritje. Rezoluta “parandaluese” ndaj bashkimit politik e miratuar nga Parlamenti Holandez dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Gjermane ku përcaktohen kufijtë e integritit european të mëtejshëm dëshmojnë për një dekadë me ambicie të kufizuara për BE-në. Vështruar nga ky prizëm, skenari i euro-sklerozës duket më i mundshmi dhe më i miri tek i cili mund të shpresohet.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

Më mirë një mur se një luftë: 50 vjet nga ngritja e Murit të Berlinit

Ndërkohë që rënia e Murit të Berlinit, e cila shënoi dhe fundin e Luftës së Ftohtë përkujtohet çdo vit në Nëntor, 13 gushti 2011 shënoi 50 vjetorin e ngritjes së tij, një ngjarje më pak festive, por e analizuar në gjithnjë e më shumë faqe historie në perëndim.

Në vitin 1961, Berlioni ishte një pikë delikate e Luftës së Ftohtë, një urë mes bllokut komunist dhe atij kapitalist. Në atë periudhë, rreth 3.000 qytetarë largoheshin çdo ditë nga Republika Demokratike Gjermane (RDGJ), kryesisht nëpërmjet Berlinit, duke e vënë Gjermaninë Lindore në rrezik rrënimi ekonomik. Bashkimi Sovjetik nuk mund ta pranonte një poshtërim të tillë dhe tundohej gjithnjë e më shumë ta merrte të gjithë qytetin. Nga ana tjetër, amerikanët dhe francezët nuk do të mund të kundërpërgjigjeshin me luftë. Kështu që ideja e rrethimit të Berlinit Perëndimor propozuar nga RDGJ u duk si një kompromis i pranueshëm për të dyja palët. Dy muaj para se muri të ndërtohej, autoritetet e RDGJ deklaruan se askush nuk kishte ndonjë plan për ndërtimin e një muri. Por, që në atë periudhë, telat me gjemba ishin porositur.

Kur u ndërtua Muri i Berlinit, në Universitetin e Lirë

Europeanët sërish në shumicë dërrmuese kundër imigracionit edhe pse ai është në rënie

Një studim ndërkombëtar në 23 vende, i bërë nga IPSO zbulon një qëndrim tejet armiqësor ndaj imigracionit në shumë vende të botës. Kryesojnë qytetarët europianë.

Shumica e të intervistuarve në vende të ndryshme si Gjermania, Afrika e Jugut, Rusia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara e shohin emigracionin me “ndikim goxha ose shumë negativ” në shoqëritë e tyre.

Ndjenjat më të forta anti-imigrantë vërehen veçanërisht në Europë, ku mbi 65% e spanjollëve, italianëve dhe britanikëve të anketuar pajtohen se “ka tepër emigrantë në vendin e tyre”.

Suedia dhe Polonia ishin të vetmet vende Europiane ku nuk ka një shumicë që konsideron se imigracioni ka ndikim negativ. Në asnjë vend të anketuar nuk ka një shumicë që e konsideron imigracionin të



Foto: Staf i EuroSpeak

(i cili ndodhet në perëndim) studionin rreth 3.000 studentë nga Gjermania Lindore. Shumë prej tyre e gjetën mënyrën për të depërtuar në Perëndim. Shumë ide kreative lindën për të fshehur dhe transportuar njerëzit që dëshironin të arratiseshin nga lindja në perëndim, duke e kthyer këtë aktivitet në një biznes të vërtetë.

Sot, Partia e Majtë, një pasardhëse moderne e partisë komuniste të Gjermanisë Lindore, ende debaton nëse muri ishte domosdoshmërisht një e keqe, edhe pse ndoshta ai nuk shërbeu me të vërtetë si një “barrierë kundër fashizmit”, siç ishte shpallur nga RDGJ. Presidenti John F. Kennedy mund të ishte dakord me këtë ide. “Një mur”, tha ai në vitin 1961, “është shumë herë më mirë se një luftë”.

The Economist, 13 gusht 2011

dobishëm.

Ndjenjat kundër imigracionit kanë impakt të rëndësishëm në lirinë e lëvizjes brenda BE-së. Më 11 gusht, Komisioni Europian miratoi masat e Spanjës për të përjashtuar nga tregu i saj i punës punëtorët rumunë. Kohët e fundit, fryma kundër imigracionit e shtyu Danimarkën të rivendoste në mënyrë të njëanshme kontrollin në kufij.

Edhe pse sipas Organizatës Ndërkombëtare të Migrimin, numri i emigrantëve në botë është rritur në mënyrë dramatike gjatë dekadës së kaluar, në fakt, për shkak të recesionit ekonomik, në BE ai ka rënë disi në vitet e fundit. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, në vitin 2009, rënie shënohen në: Francë (7%), Gjermani (13%), Spanjë (18%) dhe Itali (25%). Ndërsa gjatë po të njëjtit vit, normat e emigracionit në Irlandë dhe në Republikën Çeke pothuajse u përgjysmuan.

Euractiv, 23 gusht 2011

...vijon në faqen 7 >>



Ku po shkon politika e jashtme e BE-së?

Analizë e Giles Merritt, drejtor i institutit Friends of Europe dhe redaktor i revistës Europe's World



Në 18 muaj nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, i cili krijoi Shërbimin Europian të Marrëdhënieve me Jashtë (SHEMJ) është folur më shumë se kurrë për një Europë që duhet të ketë një zë të vetëm në çështjet botërore. Ky shërbim u bë një domosdoshmëri urgjente me "Pranverën arabe". Por një "ministri e jashtme" nuk përbën në vetvete një politikë të jashtme, dhe ka pak shenja që BE-ja do arrijë ta ketë këtë të fundit në një të ardhme të afërt.

Një politikë e jashtme Europiane nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën se si BE-ja reagon ndaj ngjarjeve, sado që kjo mund të jetë e rëndësishme. Për një bllok të përbërë nga gjysmë miliard njerëz, politika e jashtme duhet të përfaqësojë dhe të mbrojë një gamë të gjerë interesash që deri tani kanë qenë përgjegjësi e qeverive kombëtare.

BE-ja ka pranuar me kohë nevojën për një politikë të përbashkët të jashtme. Por, si gjithmonë, problemi kryesor janë qeveritë e 27 vendeve anëtare. Autoritetet e BE-së në Bruksel nuk kanë një qasje të strukturuar për marrëdhëniet ndërkombëtare që të jetë e pranueshme për ta, ose që mund të shqyrtohen dhe modifikohet në formë legjitime nga palët e interesuara në politikë, biznes dhe shoqëri civile.

Konfuzioni europian mbi çështjen e Libisë rivërtetoi se sa e vështirë është për qeveritë e BE-së të gjejnë një vizion të përbashkët. Aktualisht, SHEMJ disponon një numër shumë modest diplomatësh, çikërrima krahasuar me ata të angazhuar në shërbimet diplomatike kombëtare europiane. Konkretisht, bëhet fjalë për vetëm 1.500 diplomatë

dhe një buxhet vjetor prej më pak se një gjysmë miliardë eurosh në dispozicion të SHEMJ, përkundrejt misioneve diplomatike kombëtare të vendeve anëtare, të cilat së bashku punësojnë rreth 55.000 diplomatë me një kosto totale prej 7400 miliardë eurosh në vit.

Por dobësia kryesore e SHEMJ nuk është materiale sa ç'është intelektuale. Deri më tani, fokusi i shërbimit të jashtëm ka qenë në ndërtimin e tij, duke përfshirë këtu dhe luftërat burokratike që ka shkaktuar rezistenca e Komisionit Europian për rivalin e saj të ri. Shefi i saj, baronesha Catherine Ashton, ka tërhequr gjithashtu kritika - jo gjithmonë të drejta edhe pse është e vërtetë se ajo nuk i ka dhënë "diplomacisë europiane" një fillim të mbarë e të shpejtë.

Cilat objektiva duhet të ndjekë SHEMJ me 130 misionet e tij jashtë shtetit? Për shembull, a do të ndërhyjë kur kërcënohen interesat industriale dhe energjetike të Europës? Nuk ka pasur asnjë shenjë në këtë drejtim ende, por këto janë fusha që pothuajse të gjitha qeveritë kombëtare në BE i ruajnë me xheloz, edhe pse asnjëra prej tyre nuk ka ndikimin që do të kishte Europa e bashkuar.

Nuk nevojitet një profet që të parashikohet se intensifikimi i konkurrencës globale për burime do të thotë se europianët duhet të përdorin peshën e tyre të bashkuar në tregjet botërore, dhe në përbashkë me gjigandët e rinj ekonomikë në Azi e gjetkë. Pra, hapi tjetër për SHEMJ duhet të jetë të ulet me grupime të biznesit të madh të Europës për të përcaktuar dhe prioritetizuar fushat problematike.

"Shekulli i Azisë", do të jetë i vështirë për Europën, nëse nuk zhvillon një ekonomi të vërtetë të përbashkët

dhe vepron kolektivisht në skenën ndërkombëtare. Qeveritë europiane duhet ta shohin veten siç i shohin të tjerët, veçanërisht në SHBA. Vitin e kaluar, një raport i Institutit Brookings arriti në përfundimin se: "Është e qartë se politika e jashtme e BE-së ka evoluar si një mozaik, një amalgamë

e shëmtuar çështjesh të ndryshme që u hodhën bashkë pa menduar për strategjinë e përgjithshme." Europa nuk ka bërë ende asgjë që ta ndryshojë këtë vlerësim.

Aktualisht, Shërbimi Europian për Marrëdhëniet me Jashtë disponon një numër shumë modest diplomatësh, çikërrima krahasuar me ata të angazhuar në shërbimet diplomatike kombëtare europiane. Por dobësia e tij kryesore nuk është materiale sa ç'është intelektuale.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

...vijon në faqen 8 >>

Ish-kancelari gjerman Gerhard Schroeder bën thirrje për krijimin e “Shteteve të Bashkuara të Europës”

Ish-kancelari gjerman Gerhard Schroeder ka bërë thirrje për krijimin e “Shteteve të Bashkuara të Europës”, duke thënë se blloku e ka të domosdoshme një qeveri të përbashkët për të shmangur krizat ekonomike në të ardhmen.

Sipas Schroeder, socialdemokratit i cili drejtoi Gjermaninë në vitet 1998-2005, udhëheqësit e Bashkimit European kanë gabuar nëse kanë pritur që euro të funksiononte vetvetiu.

“Kriza e tanishme e bën tejet të qartë se ne nuk mund të ketë një monedhë të përbashkët, pa një politikë të përbashkët fiskale, ekonomike dhe sociale,” tha Schroeder.

Ai shtoi: “Ne do të duhet të heqim dorë nga sovraniteti kombëtar.”

“Komisioni European mund të funksionojë si një qeveri e mbikëqyrur nga Parlamenti European. Dhe kjo do të thotë të lindin Shtetet e Bashkuara të Europës.”

Schroeder, i cili shquhet për një marrëdhënie të ngushtë me Francën gjatë udhëheqjes së tij, tha se e mirëpret iniciativën e Kancelares Gjermane Angela Merkel dhe Presidenti Francez Nicolas Sarkozy për të lëvizur drejt një bashkim fiskal në vitin 2012.

Propozimin e tyre, që do të thotë heqje dorë nga sovraniteti mbi politikën buxhetore me qëllim për të mbështetur bashkimit prej 17 kombesh të monedhës, ka marrë një përgjigje të vakët nga vendet e tjera në zonën e euros.

“Gjermania dhe Franca kanë dërguar një sinjal të

fortë me planin për një qeveri ekonomike europiane, nëse është menduar seriozisht dhe pranon autoritetet të përshtatshëm të tillë si një ministër i financave europiane,” tha Schroeder.

Sipas tij: “Kjo është mënyra e saktë për të ecur përpara dhe parakusht për financimin euro-bonove”.

Gjermania, e cila gëzon kosto më të ulëta për dhënien e borxhit se partnerët e saj, i ka bërë rezistencë euro-bonove të përbashkëta.

Në mënyrë që të marrin jetë këto ndryshime, Schroeder tha se shtetet anëtare të BE – së do të duhet të kthehen në tryezën e bisedimeve dhe të arrijnë një marrëveshje të re për të

zëvendësuar Traktatin e Lisbonës që aktualisht shërben si kuadri institucional i bllokut.

“Në gjirin e krizës qëndron një mundësi reale për të arritur një bashkim politik në Europë” theksoi Schroeder.

Schroeder, i cili mendon se BE-ja mund t’i kundërpërgjigjet konkurrencës në rritje nga Shtetet e Bashkuara dhe Azia vetëm duke qenë plotësisht e bashkuar, e nënvizon vazhdimisht rolin e Britanisë si një pengesë për integrimin e mëtejshëm europian.

“Britania e Madhe shkakton problemet më të mëdha. Ajo nuk është në euro, por megjithatë britanikët gjithmonë duan të marrin pjesë kur është fjala për hartimin e Zonës Ekonomike Europiane,” tha ai. “Kjo gjë nuk funksionon.”

Reuters, 4 shtator 2011

Në pritje të aderimit...

Një fillim i ri në Ballkan?

Sofia Sebastian, në një policy brief të publikuar nga think tank-u spanjoll FRIDE analizon efektivitetin e

angazhimeve të deritanishme të BE-së në Ballkanin Perëndimor, duke propozuar ndryshim të strategjisë në funksion të ecjes përpara. Në këndvështrimin e autores, megjithëse Komisioneri për Zgjerimin



Foto: www.moneytrendsresearch.com



Foto: www.cartoonstock.com

Fule flet për “momentum-in e zgjerimit”, bazuar në zhvillimet e fundit shpresëdhënëse në Serbi (arrestimi i Mladic dhe Hadzic) apo fillimin e bisedimeve Serbi-Kosovë, sërish situata në Bosnje Hercegovinë, Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni mbetet e pa stabilizuar. Madje, ekziston rreziku i një zhvendosjeje të vëmendjes nga ana e BE-së nga Ballkani Perëndimor drejt Lindjes së Mesme.

BE-ja ka nisur një ndryshim rinovues të strukturës së saj në Ballkan, më i madhi që nga lançimi i procesit të Stabilizim Asociimit. Sipas Sofia Sebastian, “ky proces nuk mund të konsiderohet i plotë në rast se nuk shoqërohet me angazhime politike përkundrejt rajonit që kalojnë caqet e ristrukturimit institucional. BE-ja duhet të demonstrojë vullnetin politik dhe kapacitetin udhëheqës për të orkestruar reformat e nevojshme në Ballkanin Perëndimor, duke hequr dorë nga politika ‘të shohim e të bëjmë’, e duke përqafuar një përqasje më pro-aktive e të gjithanshme”.

Perspektiva e largët e aderimit në BE nuk ka krijuar terrenin optimist për përmbushjen e reformave, posaçërisht në rastin e Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Madje, kriza e tejzgjatur politike në Shqipëri që vazhdon që nga zgjedhjet parlamentare të qershorit të 2009, ngecja pesë vjeçare e Maqedonisë për shkak të vetos Greke, si rezultat i mosgjetjes së gjuhës së përbashkët për çështjen e emrit, apo “faktorizimi” në Bosnje i udhëheqësit të serbëve Milorad Dodik, përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të tij në zgjidhjen e konfliktit ndërmjet Republikës së Serbëve të Bosnjes dhe Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë, dëshmojnë një BE të papërgatitur në përballjen me sfidat e shtet ndërtimit të vendeve të rajonit.

Perspektiva e largët e aderimit në BE nuk ka krijuar terrenin optimist për përmbushjen e reformave. Është koha që BE-ja të kuptojë se ristrukturimi institucional pa angazhim të mirëfilltë politik në rajon, nuk e ndihmon këtë të fundit në rrugëtimin europian.

Për më tepër, në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, divergjencat ndërmjet SHBA-ve dhe BE-së, apo midis vetë vendeve anëtare të BE-së, kanë minuar në të vërtetë influencën e partnerëve ndërkombëtarë në rajon, duke i krijuar “mundësi përfitimi” udhëheqësve lokalë për të mos u angazhuar në procesin e reformave. Afërmendsh, harmonia SHBA-BE në rajon është një parakusht për shmangien e konfuzionit politik. Ndërkohë që BE-ja duhet të adresojë mungesën e koherencës së vënë re në raport me perspektivën europiane të Serbisë, në kurriz të disa çështjeve të tjera që kërkojnë vëmendje të menjëhershme.

Aplikimi i një përqasjeje vetëm teknike nga ana e BE-së brenda kuadrit të procesit të zgjerimit ka gjasa të dështojë. Lipset gjithashtu një diplomaci aktive në përballjen me situatat e paqëndrueshme, nga të cilat karakterizohen shoqëritë e Ballkanit Perëndimor. Për këtë, BE-ja duhet të përqendrojë burimet politike e diplomatike veçanërisht në Bosnje, Shqipëri dhe Maqedoni, në mënyrë që këto vende të mbështeten mjaftueshëm për sa i përket tejkalimit të krizave politike. Është koha që BE-ja të kuptojë se ristrukturimi institucional pa angazhim të mirëfilltë politik në rajon, nuk e ndihmon këtë të fundit në rrugëtimin europian.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

Gjermania i thotë haptazi Serbisë të heqë dorë nga veriu i Kosovës

Kancelarja Gjermane Angela Merkel i ka thënë haptazi Serbisë të heqë dorë nga kontrolli i veriut të Kosovës, nëse ajo dëshiron të anëtarësohet në BE. Merkel ka lëshuar ultimatumin në konferencën e përbashkët të shtypit me Presidentin Serb Boris Tadiç. në Beograd, në 23 gusht, gjatë vizitës të saj të parë në vendin aspirant për në BE.

“Nëse Serbia dëshiron të marrë statusin e vendit kandidat për në BE duhet të rinisë dialogun me

Kosovën dhe të arrijë rezultate në këtë dialog, t'i mundësojë EULEX-it të punojë në të gjitha rajonet e Kosovës dhe të heqë strukturat paralele e të mos krijojë të reja," tha ajo. "Kjo verë nuk ishte aq e mirë dhe solli një ngjarje që besonim se i përkiste të kaluarës."

Serbia ka de facto nën kontroll një enklavë të dominuar nga serbët në veri të Kosovës e cila ka një mini-qeveri të vetën, nuk pranon EULEX-in dhe thuhet se merr para dhe armë nga grupet nacionaliste serbe.

Tadiç paralajmëroi Merkel të mos shkojnë shumë larg. "Unë mendoj se një politikë që do të përballë Serbinë me zgjedhjen midis Kosovës apo BE-në është e gabuar", tha ai në konferencën për shtyp. "Për ne është e papranueshme të shpërblehet [Kosova] me krijimin e një realiteti të ri në terren të arritur nëpërmjet veprimeve të njëanshme," shtoi ai duke iu referuar miratimit të dukshëm të Gjermanisë ndaj operacionit të Forcave Speciale Kosovare. Tadiç vuri në dukje se tensionet etnike në rajon mbeten mjaft të rrezikshme dhe mund të "sjellin një konflikt të ri" në Europë. "Ne presim që Gjermania, Kancelarja Angela Merkel, të kenë mirëkuptim në të ardhmen për kompleksitetin e kësaj çështje në Ballkanin Perëndimor," tha ai.

EU Observer, 24 gusht 2011

Kroacia teston terrenin për referendum aderimi në BE

Sipas agjencisë së lajmeve HINA, nëse një referendum lidhur me aderimin e Kroacisë në BE do të mbahej në këtë periudhë, 52% e kroatëve do të votonin në favor, 38% do të votonin kundër dhe 10% do të ishin të pavendosur (sondazh Ipsos Puls, korrik 2011).

Kjo shifër edhe pse në dukje modeste, në të vërtetë shënon rritje në mbështetjen ndaj integritetit në BE, e cila gjatë një pjese të mirë të negociatave për anëtarësim ka qenë më e ulët se 50%.

Kroacia do të mbajë një referendum brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i traktatit të pranimit të saj me BE-në, ngjarje që pritet të ndodhë para fundit të vitit.

Zhvillimi i një referendumi mbi aderimin në vendin kandidat nuk është një kërkesë e BE-së,

por një vendim sovran i Kroacisë. Ndërkohë, asnjë referendum nuk është planifikuar nga vendet anëtare të BE-së mbi çështjen e pranimit të Kroacisë, për të cilën opinioni publik në BE është gjerësisht pozitiv.

Stafi i EuroSpeak, shtator 2011

Aplikimi i padëshiruar



Për shumë qytetarë në Islandë nuk është e qartë pse qeveria islandeze po i qëndron besnike iniciativës së saj për tu

anëtarësuar në Bashkimin Europian. Edhe burime nga institucionet e BE-së vënë në pikëpyetje nëse ia vlen të vazhdohet në këtë rrugëtim.

Kërkesa për anëtarësim u dorëzua në korrik 2009, në prag të kolapsit ekonomik në Islandë. Për dekada me radhë, islandezët kanë qenë kundër bashkimit me bllokun Europian, por me krizën ekonomike, mbështetësit e anëtarësimit panë një mundësi që të aplikonin për anëtarësim.

Që nga dorëzimi i aplikimit, kundërshtitë ndaj këtij procesi janë rritur ndjeshëm në Islandë. Për më shumë se dy vjet, çdo sondazh i opinionit publik ka treguar se shumica e islandezëve janë kundër anëtarësimit në BE. Më i fundit, prodhuar nga Capacent Gallup, botuar më 11 gusht tregon se 64.5 % e popullsisë është kundër anëtarësimit në BE dhe 35.5 % në favor. Duket se kërkesa për anëtarësim në BE e qeverisë islandeze është, dhe ka qenë që nga fillimi, një humbje kohe si për vetë BE-në, ashtu dhe për vetë Islandën. Populli islandeze nuk është gati të pranojë të heqë dorë nga sovraniteti dhe pavarësia, burimet natyrore, duke përfshirë dhe autoritetin e plotë mbi zonën e peshkimit rreth Islandës dhe mbi bujqësinë.

EU Observer, 16 gusht 2011



A E DINI SE?



- Mesatarisht, në vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH)*, 15% e të rinjve në moshën 20-24 vjeçare nuk janë as në shkollë e as në punë: në Danimarkë, Islandë, Japoni, Holandë dhe Norvegji më pak se 9% e të rinjve janë në këtë situatë; kurse në Itali, Poloni, Sllovakia dhe Mbretërinë e Bashkuar përqindja i kalon 18%, në Turqi ata tejkalojnë 40%.
- Në vitin 2007, në Korenë e Jugut, Islandë, Holandë, Suedi, Danimarkë dhe Norvegji, më shumë se 75% e familjeve kishin linjë interneti.
- Energjia e rinovueshme përfaqëson rreth 82% të furnizimit me energji në Islandë dhe 43% në Norvegji. Ndërsa në Japoni, Kore, Luksemburg dhe Mbretërinë e Bashkuar, ajo përbën 3% ose më pak të furnizimit me energji.
- Gjatë viteve 1971-2007, prodhimi botëror i naftës bruto është rritur me 57%. Në vitin 2007, prodhimi arriti 3 916.000.000 ton, ose rreth 82 milionë fuçi në ditë.
- Në nivel botëror, është përlllogaritur se, gjatë shekullit të XX, rritja e kërkesës për ujë ishte dy herë më e lartë se norma e rritjes së popullsisë. Përdorimi më i madh i ujit shkonte për bujqësi.
- Që nga viti 1971 e deri më sot, niveli i dioksidit të karbonit në atmosferë është rritur me 105%, ose mesatarisht 2.0% në vit. Deri në vitin 2030, ai parashikohet të rritet me 39%, ose 1.4% në vit.
- Në vitin 1971, vendet anëtare të OBEZH ishin përgjegjëse për 66% të dioksidit të karbonit të prodhuar në botë. Kontributi i tyre në ndotje ra në 45% në vitin 2007, dhe pritet të arrijë 31% në vitin 2030.
- Deri tani, rritja më e madhe në sasinë e dioksidit të karbonit të lëshuar në atmosferë ka ndodhur në Azi, ku vetëm dioksidi i karbonit i prodhuar nga Kina nga djegia e karburantit është rritur me 5.8% në vit në periudhën 1971 - 2007.
- Nga mesi i viteve 1980 deri në mesin të viteve 2000 pabarazia në të ardhura është rritur në 19 nga 24 vende anëtare të OBEZH të studiuar. Rritja është më e fortë në Finlandë, Zelandën e Re dhe Portugali.
- Ndërsa në Francë, Greqi, Turqi, si dhe Irlandë e Spanjë vitet e fundit shënohet rënie në pabarazinë mes të ardhurave të qytetarëve.
- Në vendet anëtare të OBEZH, vetëvrasja vazhdon të jetë një fenomen kryesisht mashkullor. Mesatarisht, raporti burrë-grua në rastet e vetëvrasjeve është rreth 3 me 1. Hendeku më i madh gjinor në këtë fenomen ndeshet në vende si Meksika, Polonia dhe Republika Sllovaqe dhe më i vogël në vende si Koreja e Jugut, Holanda dhe Norvegjia.
- Turizëm: Parashikohet se Europa do të vazhdojë të jetë kontinenti më i vizituar në botë, edhe pse do të ketë një rënie nga 60% në vitin 1995, në 46% në vitin 2020.

*Vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH): Australia, Austria, Belgjika, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Holanda, Islanda, Irlanda, Izraeli, Italia, Japonia, Kanadaja, Kili, Korea, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Meksika, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Republika Sllovaqe, Sllovenia, Spanja, Shtetet e Bashkuara, Suedia, Turqia, Zelanda e Re, Zvicra.

Burimi: OECD Factbook 2010



Politika dhe Pasioni: Drejt një liberalizmi më Egalitar, nga Michael Walzer

Biblioteka e Studimeve Europiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, përkthyer dhe botuar nga shtëpia botuese "Dudaj", me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri



Më në fund, Bibliotekës së Studimeve Europiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare pranë EMA-s, si dhe librarive shqiptare u shtohet një ndër titujt më të rëndësishëm të studimeve politike bashkëkohore.

Në këtë libër me interes të lartë për akademikë, studentë të shkencave politike, historisë, sociologjisë dhe për çdo lexues që ushqen interes për organizimin e shtetit dhe shoqërisë, Michael Walzer, filozof dhe teoricien i

shquar politik, profesor në Universitetin Princeton, kritikon teorinë liberale. Duke radhitur çështje shumë të debatueshme, të tilla si multikulturalizmi, pluralizmi, ndryshimet, shoqëria civile dhe drejtësia raciale e gjinore, Walzer sugjeron mënyrat se si teoria liberale mund të rishikohet për ta sjellë atë më pranë kërkesave të barazisë. Duke kombinuar dijet e thella me njohuritë praktike, Michael Walzer bën një rivlerësim të doktrineve thelbësore të mendimit liberal.

"Politika dhe pasioni" duhet të lexohet nga çdo njeri që është i interesuar për drejtësi sociale dhe për mënyrat nëpërmjet të cilave kërkojmë ta realizojmë atë!

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri.

Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG Fondacionit Friedrich Ebert.

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

★ Tashmë EMA ka një faqe të re e më të pasuruar interneti. Nëpërmjet rubrikave të reja si Dosja e Integritimit Europian dhe ajo e Liberalizimit të Vizave, faqja ofron një arkiv të besueshëm dhe lehtësisht të konsultueshëm mbi historinë e këtyre proceseve, dokumente e raporte zyrtare të institucioneve të BE-së dhe Qeverisë Shqiptare, si dhe analiza të aktorëve kryesorë jo-shtetërorë vendas dhe të huaj. Për më shumë informacion, vizitoni: www.em-al.org.